

## STATUTI SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### "GLOBAL INTERNATIONAL WATER." SHPK

**Alessandro Zocchi** qytetar italian lindur Itali me kartë identiteti AR 5734292 ,date 08-06-1953

**Moreno Zocchi** qytetar italian lindur Itali me kartë identiteti AY 5420484, date 01-11-1978

Palët e sipërshësuara bien dakort të nënshkruajnë Statutin e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës do të rregullohet nga Legjislacioni në shqiptar ne fuqi dhe nga ky Statut.

#### **Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është **"GLOBAL INTERNATIONAL WATER." sh.p.k.**

#### **Neni 2 – Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati II, Hyrja 4, Tiranë.

#### **Neni 3 –Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është për një afat të pacaktuar.


#### **Neni 4 – Objekti i Shoqërisë**

Shoqëria ka si objekt:

Konsulencë teknike. Furnizim, instalim, mirëmbajtje, riparim, projektim dhe realizim të pishinave, liqeneve të vogla, sistemeve të mirëqënies, qofshin të jashtme dhe të brëndshme; - Prodhim dhe tregtim i mbulesave të pishinave, aksesorëve dhe produkteve për pishina, si dhe të artikujve për mobilimin e kopshteve me lule; Furnizim, instalim, mirëmbajtje dhe riparim të sistemeve hidraulike në përgjithësi dhe të sistemeve për trajtimin e ujrave; - Tregtim me shumicë dhe pakicë, me anë të internetit dhe me korrespondencë të artikujve të sipërshënuar, të pjesëve respektive të këmbimit dhe materialet respektive të konsumit; - Bashkimi i pjesëve të vogla për llogari të të tretëve; - Prodhim, tregtim, instalim, mirëmbajtje dhe riparim i sistemeve energjitike të çdo lloji, në veçanti të burimeve të energjisë alternative dhe /ose të rinovueshme (për shembull, impiante solare, fotovoltaike dhe termike) dhe të artikujve në përgjithësi që lidhen me kursimin e energjisë duke përjashtuar çdo lloj aktiviteti që Ligji ia ka rezervuar profesionistëve; Tregtim, me shumicë dhe pakicë, të integrorëve ushqyes dhe të produkteve ushqyese në përgjithësi. Ajo mund të përmbushë, jo si aktivitet kryesor, ato operacione të luajtshme, të paluajtshme, tregtare, industriale dhe financiare instrumentuese për arritjen e objektit të shoqërisë, ndërmjet tyre dhe punësimin direkt ose indirekt të pjesëmarrjeve ose interesimeve në shoqëri, konsorciume ose ente italiane ose të huaja, të cilat kanë aktivitet analog ose të ngjashëm me këtë dhe ofrimin e garancive personale ose kapitale për debitë e të tretëve, duke përjashtuar të gjitha rastet e kryerjes së aktiviteteve financiare dhe të punësimit të personelit kundrejt publikut.

#### **Neni. 5 - Kapitali i Shoqërisë**

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 13.800 lekë.



5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota tërësisht të nënshkruara, të cilët kanë vlerën nominale sipas kontributeve të ortakëve në Kapitalin e Shoqërisë.

#### **Neni 6 – Kontributet dhe Kuotat**

6.1 Kontributet në Kapitalin e Shoqërisë do të bëhen si më poshtë vijon:

**Alessandro Zocchi** do të derdhë shumën prej lekë 6.900 (lekë), nëpërmjet trasfertës bankare në llogarinë e shoqërisë së themeluar e cila do hapet në emër të saj.

**Moreno Zocchi** do të derdhë shumën prej lekë 6.900 (lekë), nëpërmjet trasfertës bankare në llogarinë e shoqërisë së themeluar e cila do hapet në emër të saj.

6.2 Sipas kontributeve të sipërsënuara:

ortakut **Alessandro Zocchi** i përket një kuotë, me vlerë nominale prej 6.900 (lekë) që i korrespondon 50 % të kapitalit të shoqërisë;

ortakut **Moreno Zocchi** i përket një kuotë, me vlerë nominale prej 6.900 (lekë) që i korrespondon 50 % të kapitalit të shoqërisë.

#### **Neni 7 – Zmadhim dhe zvogëlim i kapitalit shoqëror**

Kapitali i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet nënshkrimit të palëve pjesë e kapitalit themeltar për kontributin në dorë dhe për kontributin në natyrë, nëpërmjet punësimit nga ana e gjykatës kompetente të një eksperti të autorizuar për këtë lloj kontributesh sipas kërkesës së Administratorit. pa kufizim në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve në unanimitet.

Mazhoranca nuk mund të detyrojë në asnjë rast, një partner që të rrisë kontributin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila merr vendimin me të njëjtat kushte si për ndryshimin e Statutit.

Veçgjithatë zvogëlimi i kapitalit i intereson ortakëve në proporcion të njëjëtë me pjesët respektive të kapitalit.

#### **Neni 8 – Transferimi i Kuotave**

Aksionet dhe të drejtat kontributeve do të blihen ose transferohen nëpërmjet:

- pjesëmarrjes në kapital shoqëror i autorizuar me aktin e themelimit të kësaj shoqërie;
- blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- mënyrave të tjera të parashikuara nga ligji.

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve, me përjashtim të disa dispozitave të Statutit.

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me anë të trashëgimisë.

## Neni 9 – Organi Vendimmarrës

Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës që aprovon ndryshimet në Statut sipas dispozitave të parashikuara në Ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve gëzon kompetencat për të marrë vendime lidhur me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave të shoqërisë;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe heqjen e administratorëve
- d) emërimin dhe heqjen e revizorëve të likuidatorëve të pavarur;
- e) përcaktimin e shpërblimeve të personave të cituar në pikat "c" e "d";
- f) monitorimin dhe mbikëqyerjen e mbarëvajtjes së politikave të shoqërisë nga ana e administratorit, përfshi përgatitjen e bilancit dhe raportin e performancës;
- g) adoptim i bilancit ushtrimor dhe raportet e performancës;
- h) shpërndarjen e fitimive vjetore;
- i) zmadhimin dhe zvogëlimin e Kapitalit të Shoqërisë;
- j) ndarjen e aksioneve në pjesë dhe tërheqjen e aksioneve;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në proçese gjyqësore dhe në proçese të tjera kundër administratorëve;
- l) riorganizimin dhe shkrirjen e Shoqërisë;
- m) adoptimin e rregullores së brendshme;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga Ligji ose nga ky Statut

Një ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve nga një tjetër Ortak i autorizuar ose nga një i tretë i autorizuar.

Administratori i Shoqërisë nuk mund të përfaqësojë asnjë Ortak në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve;

Autorizimi lëshohet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, duke përfshirë dhe ato të vijuese me të njëjtin rend dite.

## Neni 10. – Mënyrat e Mbledhjes së Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme së Ortakëve mbledhet me anë të letrës rekomande me kthim përgjigjë ose më postë elektronike (e-mail). Letra ose e-mail përmban vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe janë dorëzohen sëbashku me rendin e ditës dhe të gjithë anëtarëve brenda dhe jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuara për takimin.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është mbledhur në respektim të Nenit 1, Asambleja e Përgjithshme mund të përshtasë vendimin vetëm nëse të gjithë partnerët e Shoqërisë pranojnë të marrin vendimë pavarësisht parregullsive.

## Neni 11 - Kuorum

Në rastet e çështjeve që kërkojnë mazhorancë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët që zotërojnë 40 % të të drejtës së aksioneve të nënshkruara. Në rastet që kërkohet mazhorancë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse pjesëmarrësit që kanë më shumë se gjysma e numrit total të votave, marrin pjesë personalisht, me anë të një letrë rekomande me kthim përgjigjë ose me anë të postës elektronike (e-mail)



sipas nenit 88, pika 3, të këtij ligji. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk arrin kuorumin e ciptuar në nenin 1, takimi do të mbledhet me të njëjtin rend dite të propozuar brënda 30 ditëve.

### **Neni 12 – Mënyrat e vendimmarrjes**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me mazhorancë të 3/5 e votave të Ortakëve që marrin pjesë në votim për modifikimin e Statutit, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar, shpërndarjes së fitimive, të riorganizimit dhe të shkrirjes së Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me mazhorancë të votave të pjesëmarrësve për çështje të tjera si: Përcaktimi i politikave të shoqërisë; Emërimi dhe heqja e administratorëve; Emërimin dhe heqjen e revizorëve dhe likuidatorëve të pavarur; Përcaktimi i shpërblyemeve; monitorimi dhe mbikëqyerja e mbarëvajtjes së politikave të shoqërisë nga ana e administratorit, përfshi redaktimin e bilancit ushtrimor dhe rendikontimin e performaces; Përfaqësimi i Shoqërisë në proçeset gjyqësore dhe në proçeset e tjera kundër administratorëve; Adoptimi i normave të veta tëpër proçedurat e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Çdo ndryshim në Statut duhet të paraqitet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet e bëra në skedën e Shoqërisë.

### **Neni 13 – Përfshirja nga e drejta e votës**

- 1) Një Ortak nuk mund të votojë nëse Asambleja e Përgjithshme vendos të:
  - a) Vlerësojë performancën e tij;
  - b) Nuk respekton çfarëdolloj detyrimi;
  - c) çfarëdolloj ankesë kundër tij në emër të shoqërisë;
  - d) dhënien ose jo të një përfitimin të ri;
- 2) Kur një Ortak përfaqësohet nga një prokurator, i cili konsiderohet në të njëjtin pozicion për sa i përket konfliktit të interesit të anëtarit që përfaqëson.

### **Neni 14 – Administrimi**

14.1 Në këtë akt emërohet 1 (një) administrator shoqërie si vijon:


**Alessandro Zocchi** shtetas italian, i lindur nëtali më 08.06.1953 i pajisur me Kartë Identiteti AR5734292

14.2 Administratori ushtron të gjitha kompetencat e tij në përputhje me gjithçka është parashikuar në Nenin 95 të Ligjit nr. 9901 datë 14/08/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" datë 14 prill 2008, dhe të nenit 14 të Statutit.

14.3 Administratori ushtron të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe proçedurat e nevojshme për themelimin e shoqërisë sipas Legjislacionit dhe normativës në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori mund të kërkojë ndihmën e personave të tretë si konsulentë të cilëve mund tu delegojë pjesërisht ose tërësisht kryerjen e këtyre veprimeve.

14.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër dhe për llogari të shoqërisë në themeluar deri në regjistrimin pranë një Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Administratori është i autorizuar të nënshkruajë të gjitha aktet dhe të marrë në emër të Shoqërisë detyrimet që rrjedhin nga momenti i regjistrimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të delegojë kompetencat e tij edhe tek avokatë të tjerë të veçantë.

### **Neni 15 – Gjuha**



**Neni 15 – Gjuha**

15.1 Ky akt hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me kopjet e përkthyer në gjuhën italiane bashkangjitur.

15.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me interpretimin e akteve dhe dokumentave të parashtruara, versioni në italisht do të jetë ligjërish i detyrueshëm.

**TIRANE ME 15.02.2018**

**ORTAKËT**

Zoceri TARENO



Zoceri ALESSANDRO

